

Sidoqoftë, Shoqata e pensionistëve të Tetovës, si pjesë e LSHPM, gjatë takimeve me përfaqësues të partive politike, do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna nga Lidhja e Shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, pjesë e së cilës është

Në prag të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut, të cilat parashihet të mbahen me 19 tetor të këtij viti, përfaqësues të partive politike, në agjendat e tyre kanë edhe takimet me pensionistët.

Gjatë periudhës së kaluar, disa nga përfaqësuesit politik që veprojnë në rajonin e Pollogut të Poshtëm, që përfshinë Komunën e Tetovës dhe komunat tjera rurale, i kanë intensifikuar aktivitetet e tyre politike, duke zhvilluar takime me qytetarë, në bashkësi vendore, lagje në qytet, organizata joqeveritare, përfshirë edhe Shoqatën e pensionistëve të Tetovës.

Natyrisht, Shoqata e pensionistëve të Tetovës për të gjithë përfaqësuesit politik, pa marrë parasysh orientimin e tyre politik, i ka hapur dyert për t'i zhvilluar takimet e planifikuara nga subjektet politike.

Shoqata tetovare, si organizatë apartiake, joprofitabile që punon dhe angazhohet në realizimin e interesave të anëtarësisë, ka përpiluar një tekst me kërkesa që janë

SHP TETOVË

PENSIONISTËT TETOVAR NË TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE



në interes të pensionistëve e që duhet t'i përmbushin vetëqeverisjet lokale. Pas konstatimit se që nga fillimi i sistemit shumëpartiak, në vitet e nëntëdhjeta e deri më tash, asnjë strukturë komunale nuk ka bërë pothuaj asgjë për të mirën e pensionistëve, është koha që strukturat e reja udhëheqëse të komunës t'i kenë parasysh pensionistët dhe t'i trajtojnë ata si qytetarë të denjë, duke i mbështetur në aktivitetet që ata i zhvillojnë.

Për dallim nga ne, Shoqatat tjera të pensionistëve në shtet kanë një status shumë më të mirë dhe bashkëpunim konkret me vetëqeverisjet lokale, e që përbëhet nga kontaktet e rregullta mujore, ndihmë të drejtpërdrejtë materiale për çdo vjet, ndihmë gjatë realizimit të aktiviteteve kulturore e zbavitëse të Shoqatës dhe

pjesëmarrje në punën e Këshillave komunal, në seancat kur diskutohet për çështje me interes për pensionistët.

Do theksuar se Shoqata e pensionistëve të Tetovës është shoqatë më e suksesshme në vend, në të gjitha aspektet, duke filluar nga natyra e organizimit të aktiviteteve, rezultate kulminante të arritura në nivel Rajonal e Republikan, si në garat sportive të pensionistëve, ashtu edhe në Revytë folklorike të këngëve, valleve e muzikës. Tek ne, në nivel të komunës, këto rezultate fare nuk regjistrohen si suksese dhe të arritura të Shoqatës. Këto suksese nuk janë vetëm të Shoqatës por edhe të komunës në përgjithësi, andaj komuna ka obligim t'i mbështesë e trajtojë pensionistët si pjesë e barabartë e mbarë popullatës.

Qyteti i Tetovës si njësi e vetëqeverisjes lokale, fare nuk ka ndonjë përkujdesje për pensionistët, të cilët kanë nevojë për përkujdesje dhe ndihmë nga personat e tretë, ndërsa rastet e btitlla janë lënë në ngarkesë të Shoqatës, apo secili rast të gjejë mënyrën e trajtimit ashtu siç mundet, edhe pse Shoqata nuk është kompetente për trajtimin e rasteve të tilla.

Një problem tjetër paraqet mungesa e parkut të qytetit, për qëndrim e shoqërim të pensionistëve. Qyteti i Tetovës është i vetmi në vend që nuk ka park, ndërsa vlerësojmë se kështu do të mbetet edhe një kohë të gjatë, duke pasur parasysh politikën urbanistike që po zhvillohen.

Një problem tjetër për qytetin është edhe mungesa e Shtëpisë për akomodimin e personave të

moshuar, të cilin problem nuk e kanë qytetet tjera. Për këto shkaqe, jemi të detyruar që një pensioniste të shoqatës sonë ta vendosim në Shtëpinë e të moshuarve në Kumanovë, ku ka kushte optimale për akomodimin e personave të moshuar. Krerët tanë komunal duhet të jenë të vetëdijshëm se për çdo ditë po rritet numri i personave të tillë, të cilët kanë nevojë për akomodim kolektiv. Me shkuarjen e të rinjve në shtetet e Evropës perëndimore, gjendja e këtillë do të përkeqësohet vazhdimisht.

Shpresojmë dhe kërkojmë nga Kryetari i ardhshëm i komunës dhe nga Këshilltarët komunal, në periudhën e ardhshme t'i kushtojnë më shumë kujdes këtyre çështjeve të hapura që kanë të bëjnë me pensionistët, me qëllim të zgjidhjeve të problemeve të moshave të treta dhe gjithsesi kjo është edhe në interes të komunës. Në këtë kuptim, do ishte e udhës që një anëtar i shoqatës së pensionistëve të jetë pjesë e ndonjë komisioni komunal, i cili do merr pjesë në takime ku do të diskutohet për moshat e treta. Po kështu Shoqata mund të bashkëveprojë me organet komunale për çështje siç janë rrualtja e pastërtisë publike në qytet, krijimi i këndeve për qëndrim të pensionistëve, organizimi i kontrolleve me ekepe të përbashkëta pune në qytet për të parandaluar keqpërdorimin e ujit të pijshëm, e kështu me radhë.

Sidoqoftë, Shoqata e pensionistëve të Tetovës, si pjesë e LSHPM, gjatë takimeve me përfaqësues të partive politike, do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna nga Lidhja e Shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, pjesë e së cilës është. M. Murseli

SHP PRILEP

Prilepi do të ketë një qendër ditore për të moshuarit për plakje aktive

Nga Qendra për Zhvillim dhe Edukim – Prilep theksojnë se kjo është një tjetër iniciativë e suksesshme e përbashkët me Komunën e Prilepit, e cila përfaqëson një hap të rëndësishëm në kujdesin ndaj të moshuarve

Në Komunën e Prilepit, në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim dhe Edukim, së shpejti do të hapet një Qendër për Plakje Aktive për të Moshuarit në qytet. Hapësira do të adaptohet në ndërtesën e vjetër të bashkësisë lokale "Rid", dhe rinovimi pritët të përfundojë deri në fund të muajit të ardhshëm, domethënë deri në fund të shtatorit. Qendra do të fillojë të funksionojë në fillim të vitit 2026. Ky projekt, siç u tha nga qeveria lokale në Prilep, është pjesë e grantit të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, me mbështetjen e Bankës Botërore, dhe do të jetë qendra e pestë e këtij lloji në vend.

Institucioni do të ketë një kapacitet për 48 përdorues, të cilët do të qëndrojnë në dy ndërrime, 4 orë në ditë, nën mbikëqyrjen e një ekipi prej katër profesionistësh. "Qendra e kujdesit ditor për plakjen aktive përfaqëson një hap të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie humane, gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme. Kjo qendër nuk është vetëm një hapësirë ku qytetarët e moshuar do të kalojnë kohën e tyre, por një burim i vërtetë për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, përmes promovimit të konceptit të plakjes aktive. Me mbështetjen e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, si dhe Bankës Botërore, po

rindërtojmë hapësirën ekzistuese dhe po krijojmë shërbime të reja sociale të adaptuara në përputhje me nevojat reale të popullsisë së moshuar. Më shumë se një javë më parë, nënshkruam marrëveshjen e grantit me Ministrinë, si pjesë e Projektit të Përmirësimit të Shërbimeve Sociale, hapi i parë konkret që po e përkthejmë në realitet sot. Jemi krenarë që Prilepi po krijon një qendër të këtij lloji, e cila forcon aksesin në mbrojtje sociale dhe demonstroi kujdes të vërtetë për qytetarët. Kjo qendër është një simbol i solidaritetit ndërgjeneracional dhe konfirmim se çdo kategori qytetarësh meriton një jetë dinjitoze", tha Kryetari i Komunës



së Prilepit, Borçe Jovčeski.

Nga Qendra për Zhvillim dhe Edukim – Prilep theksojnë se kjo është një tjetër iniciativë e suksesshme e përbashkët me Komunën e Prilepit, e cila përfaqëson një hap të rëndësishëm në kujdesin ndaj të moshuarve. "Qendra do të ofrojë mbështetje sociale dhe shëndetësore për të moshuarit, punë me psikologë, lidhje me punonjës shëndetësorë, si dhe aktivitete edukative dhe kulturore. Të gjitha shërbimet do të ofrohen nga stafi profesional që do të punësohet në

qendër.

Vlera totale e projektit është rreth 7 milionë denarë – nga të cilat 2 milionë janë planifikuar për rikonstruksionin dhe pajisjen e hapësirës prej 100 m², ndërsa 5 milionë denarë të tjerë janë të destinuar për punësimin e katër personave, shpenzimet e përgjithshme dhe sigurimin e materialeve të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në vitin e parë", theksoi Marina Tosheska nga Qendra për Zhvillim dhe Arsim – Prilep. K. Risteski